

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl.-Kzz. 9/2013

Prishtinë

10 shtator 2013

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit, Gjyqtarët e Kosovës Gyltene Sylejmani dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit, në prani të Zyrtarit ligjor Holger Engelmann si procesmbajtës, në lëndën penale Pkl.-Kzz. Nr. 9/2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës

Kundër të pandehurve:

1. M.D. i lindur më _____ Komuna e Pejës, _____, shqiptar i Kosovës, vendbanimi _____ Kosovë, student, i martuar, _____ ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, në paraburgim që nga data 1 mars 2010 deri më 28 maj 2010 dhe prapë nga 16 qershori 2010 deri 22 shtator 2010 e më pastaj nën masën e sigurisë së lajmërimit në stacionin e policisë.
2. B.M. i lindur më _____ shqiptar i Kosovës, _____ Kosovë, student, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, nuk është i dënuar më parë, në paraburgim që nga data 1 mars 2010 deri më 28 maj 2010 dhe prapë nga 16 qershori 2010 deri 22 shtator 2010 e më pastaj nën masën e sigurisë së lajmërimit në stacionin e policisë.
3. A.V. i lindur më _____ shqiptar i Kosovës, _____ punësuar në _____, _____ të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, nuk është i dënuar më parë, në paraburgim që nga data 1 mars 2010 deri më 28 maj 2010 dhe prapë nga 16 qershori 2010 deri 22 shtator 2010 e më pastaj nën masën e sigurisë së lajmërimit në stacionin e policisë.

Që të tre të shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, të datës 16 shtator 2010, P. Nr. 128/2010 që së bashku dhe në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale

Detyrim në kundërshtim të nenit 267 paragrafët 2 dhe 1 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), sepse në Pejë në mes nëntorit dhe dhjetorit 2009, duke vepruar si anëtarë të grupit, me qëllim të përfitimit material të madh e të paligjshëm, kanë kërcënuar E.L. me fjalët: “” mos mendo se ne dimë vetëm të thyejmë xhama“ dhe “po ju paralajmëroj” për ta shtrënguar atë t’ju ia në 150.000 euro gjysmën e të cilave në fakt i kishin dhënë përmes ndërmjetësit N.H. te M.D. në dhjetor 2009;

dhe

Detyrim në tentativë në kundërshtim të nenit 267 paragrafët 1 dhe 2 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, sepse në Pejë më 28 shkurt 2010, duke vepruar si anëtarë të grupit, ata kanë ndërmarrë veprim të drejtpërdrejtë në ta shtrënguar E.L. t’ju japë atyre 75.000 duke e kërcënuar ndërmjetësin N.H. duke thënë se nëse pjesa e mbetur prej 75.000 Euro nuk do t’iu jepej atyre, Peja do të digjej, por nuk kanë pranuar paratë për shkak të refuzimit të E.L. që ta paguaj shumën e lartpërmendur.

Prandaj, ata janë dënuar me dënim unik prej dy (2) viteve dhe gjashtë (6) muajve burgim për secilin sipas nenit 71 paragrafëve 1 dhe 2, nën-paragrafit 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), nga dy (2) vite burgim për secilin për veprën penale Detyrim në bashkëkryerje sipas nenit 267 paragrafëve 1 dhe 2 në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe një (1) viti burgim për secilin për veprën penale Detyrim në bashkëkryerje sipas nenit 267 paragrafëve 1 dhe 2 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, përfshirë llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim në mes të 01 marsit 2010 dhe 28 majit 2010 dhe nga 16 qershori 2010 e tutje, sipas nenit 391 paragrafit 1, nën-paragrafit 5 dhe nenit 278 paragrafit 7 të KPPK-së.

Aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar kundër të tre të pandehurve në shkallën e dytë me anë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.-Kz. Nr. 28/2011, të datës 11 maj 2012, sipas nenit 426 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit janë shpallur fajtorë për veprat penale Detyrim në bashkëkryerje sipas nenit 267 paragrafëve 1 dhe 2 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, sepse në Pejë në mes nëntorit 2009 dhe shkurtit 2010, duke vepruar si grup, me qëllim të përfitimit material të madh e të paligjshëm, kanë ndërmarrë veprim të drejtpërdrejt për ta detyruar E.L. t’ju japë 150.000 euro duke e kërcënuar ndërmjetësin N.H.

Prandaj, dënimet për M.D. dhe B.M. ndryshuar në tri (3) vite burgim për secilin dhe dënimi për A.V. në dy vite burgim.

Duke vepruar në lidhje me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës / A.V. Av. G.R. në 22 tetor 2012 e plotësuar më 29 janar 2013, si dhe e mbështetur me një dokument plotësues nga avokatët mbrojtës të / A.V. Av. L.S. dhe Av. / B.L. të paraqitur më 3 shtator 2013, dhe pas kërkesës së përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur më 4 dhjetor 2012 nga avokatët mbrojtës Av. / Z.B. dhe Av. / Z.B. në emër të pandehurve / M.D. dhe / B.M. të drejtuar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 16 dhjetor 2010 (P.Nr.128/10) dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 11 maj 2012 (Ap.-Kz. Nr. 28/2011),

Lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në emër të pandehurit / A.V. dhe kërkesa e përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në emër të pandehurve / B.M. dhe / M.D. kundër aktgjykimit P. 128/2010 të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 16 shtator 2010, dhe aktgjykimit AP.-KŽ. 28/2011 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 11 maj 2012, REFUZOHEN SI TË PABAZUARA.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Më 29 mars 2010, Prokurori Publik i Qarkut në Pejë ka ngritur aktakuzën (PP.nr.84/2010) kundër / M.D. / B.M. dhe / A.V. duke i akuzuar ata për kryerjen e veprës penale Detyrim në shkelje të nenit 26 / paragrafi 2 të KPK-së. Sipas Prokurorit, tre të pandehurit, duke vepruar si grup, kanë detyruar Ekrem Llukën që t'ua paguaj shumën prej 150.000 Euro në mënyrë që t'ia lejojnë atij që lirshëm ta blejë hotelin për të cilin kishte dhënë ofertën më të lartë.

Aktakuza është konfirmuar nga gjyqtari për konfirmim i Gjykatës së Qarkut në Pejë më 29 prill 2010.

Depozita e ofertës dhe shuma prej 25% e ofertës tanimë të paguar nga / E.L. paraprakisht dhe sipas rregullave të tenderit të Agjencisë Kosovare për Privatizim (AKP-së) i janë kthyer nga AKP të K.P.K. / i e / E.L.

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në shtatë seanca më 4, 5, 12, 24 dhe 25 gusht si dhe më 15 dhe 16 shtator 2010, dhe provat në vijim janë vlerësuar nga gjykata:

Pala e dëmtuar E.L. dhe N.K. dhe A.E. dëshmitarët N.H. dhe K.B. raporti i policisë i datës 21 nëntor 2009, numri i lëndës 2009-DA-3199, raporti i policisë i datës 22 dhjetor 2009, numri i lëndës si më lart; raporti i policisë i datës 22 shkurt 2010, numri i lëndës 2010-DA-436; kallëzimi penal i datës 2 mars 2010, numri i lëndës 2010-DA-436; Memorandumi zyrtar i Njesisë Regjionale të Hetimeve i datës 5 mars 2010, ref. nr. HE/PE-06/2010; kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për informata të përgjithshme hetimore e datës 8 mars 2010; disa dokumente në lidhje me procedurën e privatizimit të H. në Banjën e Pejës të siguruar kolegjit nga dëshmitarja K.B. më 12 gusht 2010; dokumente dhe një CD me përmbajtje të procedurës së privatizimit të H. në Banjë të Pejës në marra nga Policia nga AKP-ja në bazë të urdhrin të lëshuar nga kolegji më 16 gusht 2010, raporti i policisë mbi regjistrimin e thirrjeve telefonike dhe SMS-ve, nr. I lëndës 2010-DA-436, i datës 6 shtator 2010; regjistri i telefonit dhe përmbajtja e SMS-ve për numrat: A.V. dhe B.M. dhe M.D. dhe N.H. për periudhën e koncesionit në mes të 1 nëntorit 2009 dhe 1 marsit 2010; raporti i policisë mbi zbulimin financiar lënda nr. 2010-DA-436 8 shtator 2010; zbulimi financiar i xhirollogarive bankare të F.Z. "ShPK, E.L. dhe N.H. marrëveshja e partneritetit në mes të A.E. dhe M.D., e datës 20 tetor 2009 si deklaratat e dhëna nga tre të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor më 25 gusht dhe 15 shtator 2010.

Si rezultat, Gjykata e Qarkut në Pejë ka vendosur siç është përmendur më lartë.

Pas ankesave të të pandehurve përmes avokatëve të tyre mbrojtës, Gjykata Supreme e Kosovës – pas rivlerësimit të lëndës – ka lëshuar aktgjykimin e saj (AP-Kz- 28/2012) më 11 maj 2012 dhe ka vendosur siç është përshkruar më lartë.

Kundër të dy aktgjykimeve, brenda afatit kohor janë paraqitur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga avokatët mbrojtës Av. Z.B. dhe Av. Z.D. i emër të pandehurve M.D. dhe B.M., më 4 dhjetor 2012 dhe nga avokati mbrojtës Av. G.R. në emër të pandehurit A.V., më 16 tetor 2012 dhe është plotësuar më 17 janar 2013 gjithashtu është plotësuar nga avokatët mbrojtës Av. L.S. dhe Av. Belo më 30 gusht 2013. Avokatët mbrojtës së bashku pretendojnë në shkelje esenciale të procedurës nga të dy aktgjykimet dhe i propozojnë Gjykatës Supreme që të anulohet të dy vendimet e mëparshme dhe ose të kthejë lëndën në rigjykim ose t'i liroj të pandehurit nga të gjitha akuzat.

Më 28 janar 2013, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) ka dorëzuar përgjigjen në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë gjithashtu - edhe në lidhje me dokumentin plotësues të Av. S. dhe Av. I. në 04 shtator 2013, kërkesën plotësuese, me propozim për refuzimin e të gjitha kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuara dhe vërtetimin e aktgjykimeve në tërësi.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

1. Pranueshmëria e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë

Të gjitha kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pranueshme. Ato janë paraqitur pranë gjykatës kompetente sipas nenit 453 të KPPK-së dhe brenda afatit kohor sipas nenit 452 paragrafit 3 të KPPK-së. Edhe pse dokumenti i dorëzuar nga avokatët mbrojtës të pandehurit, A.V., të datës 30 gusht 2013 përmbajnë kërkesa të sakta të mbrojtjes, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se ky dokument i titulluar si 'Dokument plotësues në Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë' siç është paraqitur nga i pandehuri, ofron vetëm arsyetim shtesë nën kërkesën e të pandehurit, por nuk e ka kualitetin e kërkesës së veçantë për mbrojtjen e ligjshmërisë nga mbrojtja.

2. Procedura e zhvilluar nga Gjykata Supreme

Kolegji i Gjykatës Supreme ka vendosur në seancë sipas nenin 454 të KPPK-së.

3. Lidhur me meritat e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Shkeljet e pretenduara të nenit 403 të KPPK-së

Të gjithë avokatët mbrojtës në parashtrësat e tyre pretendojnë në shkelje të procedurës penale, se kishte pasur prova përmes disa dëshmitarëve se i pandehuri, A.V., nuk ka pasur asnjë rol në krimin e ngarkuar apo madje as nuk ka qenë personalisht i njohur për të pandehurit apo ndërmjetësuesin N.A. po që – gjithashtu sipas deklaratave të dëshmitarëve – sjellja e dy të pandehurve të tjerë nuk ka përmbushur kushtet e kërcënimit apo forcës kundër E.L.

Për më tepër, avokatët mbrojtës Av. L.S. dhe Av. B.I. ë emër të pandehurit A.V. kanë theksuar se E.L. kishte përshkruar një 'kthesë U' gjatë deklaramit para gjykatës, por që shkalla e parë kishte vlerësuar të gjitha provat ekskluzivisht në dëm të të pandehurit.

Gjykata Supreme gjen se të gjitha pretendimet e mbrojtjes nuk përputhem me kushtet e shkeljeve procedurale nga Gjykata e Qarkut në Pejë. Aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i paqëndrueshëm në brendi apo kundërthënës me arsyetimin.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësim të hollësishëm të të gjitha provave në dispozicion dhe – përveç kësaj – të gjitha provat e marra parasysh kanë qenë të pranueshme në kohën kur janë marrë dhe në pajtim me

KPPK-në e aplikueshme në atë kohë. Si pasojë e logjikshme e këtij vlerësimi, Gjykata e Qarkut në Pejë i ka shpallur fajtor dhe ka shqiptuar dënimet siç janë përshkruar më lartë.

Gjithashtu edhe kolegji ankimor i Gjykatës Supreme i shkallës së parë e ka parë këtë dhe prandaj - pas diskutimit të të gjitha aspekteve relevante të lëndës - ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë por - në parim - ka vërtetuar shpalljen fajtorë.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimet e mbrojtjes - edhe pse të gjithë pretendojnë në shkelje të procedurës penale - në realitet ata i referohen vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga Gjykata e Qarkut.

Në lidhje me fazën aktuale të procedurës, referencë i është bërë nenit 451 paragrafit 2 të KPPK-së, sipas të cilit Gjykata Supreme nuk do të rivlerësojë aspektet e vërtetimit të gabuar të fakteve. Duke pasur parasysh vlerësimin e hollësishëm të provave të bërë nga Gjykata e Qarkut, nuk ka hapësirë për nenin 458 të KPPK-së, sipas të cilit Gjykata Supreme do të anulojë aktgjykimet e mëparshme dhe do të urdhëroj shqyrtim të ri gjyqësor, nëse në procedurë me kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë *'dyshim të konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara në vendimin kundër të cilit është paraqitur kërkesë'*. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se nuk ekziston *'dyshim i konsiderueshëm'* i tillë në lëndën në fjalë. Është detyrë e gjykatës së shkallës së parë që t'i vlerësojë provat dhe të arrijë në përfundim se çfarë ka ndodhur kur është kryer krimi. Këtë Gjykata e Qarkut në Pejë e ka bërë në mënyrë të drejtë.

Nën këto rrethana, mund të mbetet e hapur çështja nëse argumentet e paraqitura nga avokatët mbrojtës Av. L. S. dhe Av. B. I. emër të pandehurit A. V. akoma do të mund të merren parasysh për shkak se dorëzimi i argumenteve plotësuese në një fazë të mëvonshme duhet të lejohet, ose nëse ato duhet të refuzohen si të paafatshme, duke pasur parasysh se parashtresat e referuara janë paraqitur më 30 gusht 2013, kurse afati për dorëzimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë tanimë ka skaduar më 2012.

III. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës përfundon se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë refuzohen si të pabazuara.

Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë si në dispozitiv, në bazë të nenit 456 të KPPK-së.

Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtës:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Pkl.-Kzz. No. 9/2013
Prishtinë
10 shtator 2013